

VENDIM
Nr. 182, datë 6.3.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRJETIT UJËSJELLËS ME
PUSE SHPIMI NË PLAZHIN E DIVJAKËS DHE ZGJERIMI I RRJETIT TË DIVJAKËS, NË
BASHKINË E DIVJAKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrjetit ujësjellës me puse shpimi në plazhin e Divjakës dhe zgjerimi i rrjetit të Divjakës, në bashkinë e Divjakës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Divjakës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerën përkatëse sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 3186 (tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) m², tokë arë, në vlerën e përgjithshme prej 2 136 564 (dy milionë e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 136 564 (dy milionë e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Divjakës, në buxhetin e saj.

5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Divjakës.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Divjakës, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 3186 (tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) m², tokë arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Divjakës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë pranë bashkisë së Divjakës. Deri në këtë çast, paratë të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Divjakës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha